



# KONTROLLI I LARTË I SHETIT K R Y E T A R I

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë. Tel. 04.224 332

Nr. 1231/20 Prot.

Tiranë, më 30/04/2017

## V E N D I M

**Nr. 39, Datë 30/04/2017**

### PËR

### AUDITIMIN E USHTRUAR

### NË BASHKINË TEPELENË DHE 3 ISH-KOMUNAT QENDËR TEPELENË, LOPËS DHE KURVELESH "MBI AUDITIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE"

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësisë të Qeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15 dhe 30 të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

## V E N D O S A:

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare" të ushtruar në Bashkinë Tepelenë dhe 3 ish-Komunat; Qendër Tepelenë, Lopës dhe Kurvelesh, për periudhën nga data 01.01.2012 deri 31.12.2016.

**II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

### A. MASAT ORGANIZATIVE:

**1. Gjetje nga auditimi:** Nuk njihen plotësisht dhe nuk janë implementuar kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" për 5 komponentët, dhe konkretisht:

**-Mjedisi i kontrollit.** Nuk është miratuar Kodi i Etikës në kundërshtim me kërkesat e nenit 20 të ligjit nr. 10296 datë 08.7.2010.

Është miratuar rregullorja e funksionimit të brendshëm, por kjo rregullore, nuk ka parashikuar detyra për të gjithë sektorët e strukturës organizative përfshi detyra për Njësitë Administrative dhe Administratorët e tyre.

**-Menaxhimi i riskut.** Në zbatim të kërkesave të nenit 21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, është caktuar koordinatorë e riskut por nuk janë evidentuar risqet dhe nuk janë marrë masat për menaxhimin e tij.

**-Veprimtaritë e kontrollit.** Titullari i njësisë, nuk ka miratuar veprimtaritë e kontrollit, përfshirë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm. Nuk janë përcaktuar gjurmët e auditimit të veprimtarive, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 8.7.2010, neni 4 pika 19

**-Edhe për informacionin dhe komunikimin** nuk janë miratuar procedura dhe rregulla të shkruara por veprohet bazuar në hierarkinë administrative sipas strukturës organizative të miratuar me vendim të Këshillit të Bashkisë. Nuk janë përcaktuar gjurmët e auditimit të veprimtarive, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 8.7.2010, neni 4 pika 19.

Nuk janë përcaktuar rregulla për administrimin dhe ruajtjen e aktiveve të qëndrueshme.

**1.1. Rekomandimi:** Bashkia Tepelenë, të marrë masa për të realizuar njohjen e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” nga të gjithë punonjësit e saj përmes trajnimeve dhe të punojë për implementimin e kërkesave kryesore që burojnë nga ky ligj në drejtim të mirë menaxhimit të aktivitetit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën 2012-2016, janë konstatuar 43 raste të vendimeve gjyqësore të formës së prerë në vlerën 5,191,515 lekë të fituara nga personat për largime të pa drejta nga puna. Një pjesë e këtyre detyrimeve janë paguar nga Bashkia Tepelenë dhe në fund të vitit 2016 janë të pa paguara për 12 persona shuma 1,745,560 lekë.

**2.1. Rekomandimi:** Nga Këshilli i Bashkisë Tepelenë të analizohen 12 rastet e detyrimeve në vlerën 1,745,560 lekë si rezultat i largimeve të pa motivuara nga puna të punonjësve dhe për mos ndjekjen e proceseve gjyqësore në të gjitha shkallët e gjykimit.

*Brenda Muajt Qershor 2017*

**3. Gjetje nga auditimi:** Në vitin 2013, është kontabilizuar në llogaritë kreditore vlera 2,884,255 lekë në analizë të 14 personave. Kjo vlerë përfaqëson detyrimin që Bashkia Tepelenë, merr përsipër për tu paguar 14 personave të cilëve në vitet 2008-2009 u ka shitur truall publik gjithsej 1,716 m<sup>2</sup>, me argumentimin se këta persona kanë legalizuar ndërtime mbi këto troje dhe kanë ripaguar vlerën e truallit pranë ALUIZNI-t. Për 3 persona, Bashkia Tepelenë ka paguar vlerën e detyrimit kreditor për 800,752 lekë. Ky veprim kontabël, nuk është mbështetur në dokumentacionin e nevojshëm ligjor, veprimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar nenet 3, pika 8 dhe neni 6, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurës administrative i Republikës të Shqipërisë”, nenet 3, 4, 15, 16, 18, 22, 58, 82, 116, 117/2 etj, dhe VKM nr. 54, datë 5.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurës të mënyrës së dhënies me qira”.

**3.1.Rekomandimi:** Bashkia Tepelenë, të procedojë sipas kërkesave ligjore për anulimin e këtij veprimi kontabël me dëm ekonomik në vlerën 2,884,255 lekë, personat e interesuar për këtë problem të orientohen që të ndjekin rrugën gjyqësore.

*Menjëherë*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga evidentimi i konsumit të karburantit, me fletë udhëtimi dhe krahasimi i konsumit sipas normativave të miratuara, u konstatuan se disa raste, rezultojnë me kursim karburanti:

-Në vitin 2013, rezulton e kursyer sasia 419 litra në vlerën 73,325 lekë.

-Në vitin 2014, rezulton me kursim 5922 litra në vlerën 1,065,960 lekë.

-Në vitin 2015, rezulton me kursim 4089 litra për vlerën 666,540 lekë.

**4.1. Rekomandimi:** Të merren masa, të rishikohen normativat e konsumit të karburantit sipas llojeve të automjeteve, duke ngritur për këtë komisione të specializuar. Për ndjekjen e konsumit të karburantit, të caktohet një person nga Sektori i Financës ose nga Sektori i Shërbimeve.

*Brenda Muajt Maj 2017*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi rregullshmërinë dhe saktësinë e pasqyrave financiare, u konstatuan disa pasaktësi:

-Llogaria e aktivitetit të bilancit 202 “Shpenzime për studime ose kërkime”, për vlerën e debisë 5,623,000 lekë në analizë të saj ka të evidentuar vlerën e shpenzimeve për studime projektimi dhe oponenca teknike të kryera në vite. Për këto aktive, nuk janë hapur kartela inventariale për personat që i kanë në ngarkim dhe i administrojnë këto studime dhe projekte.

-Nuk janë përpiluar pasqyrat përmbledhëse të konsoliduar e të ardhurave dhe shpenzimeve të funksionimit (Formati nr. 11), në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për Institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe Njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj” i ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007, pika 3.

-Nga Bashkia Tepelenë, për 6 mujorin e parë të vitit 2015, janë nxjerrë pasqyrat financiare të konsoliduar ku përfshihet gjendja ekonomike financiare e ish Komunave Qendër, Kurvelesh dhe Lopës. Nxjerrja e këtyre pasqyrave, nuk është rakorduar me gjendjen fizike të aktiveve, pasi nuk janë kryer inventarizimet e aktiveve në këto ish-Njësi të Qeverisjes Vendore. Konstatohet se llogari 213 “Mjete transporti” në pasqyrat financiare, rezulton më tepër se sa inventari fizik i kryer për vitin 2016 në shumën 1,600,200 lekë, nga të cilat:

-1,246,000 lekë për mungesë të mjeteve të transportit në ish Komunën Lopës dhe

-354,200 lekë për mungesa të vlerave inventariale në ish Komunën Qendër.

- Llogaritë e aktivitetit të bilancit 212 “Ndërtime dhe konstruksione” si dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, në analizën e tyre, për 6 mujorin e parë të viti 2015, rezultojnë me diferenca të mëdha nga ato të pasqyruar në Aktivin e Bilancit. Konkretisht për vlerën 11,048,276 lekë llogaria 212 në ish Komunat Lopës dhe Kurvelesh dhe për vlerën 11,048,276 lekë llogaria 213 në ish Komunën Qendër.

Përsa më sipër, janë shkelje të kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, nenet 7, 9 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III pikat 26, 35/b, 35/c dhe kap IV, pika 73 dhe VKM nr. 510, datë 10.6.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, Kreu III, pika 1.

**5.1. Rekomandimi:** Sektori i Financës të marrë masat dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për të sistemuar kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, me qëllim që ato të pasqyrojnë gjendjen reale të aktiveve të Bashkisë Tepelenë dhe të tre Njësive Administrative të vartësisë. Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanistikës dhe të Shërbimeve, bazuar në të dhënat kontabël, të marrin masat dhe të organizojnë evidencën e inventarit të studimeve dhe projekteve të investuara në vite në Bashkinë Tepelenë dhe në ish Komunat, sot Njësi Administrative. Administrimi i tyre të bëhet sipas procedurave ligjore, me kartela inventari, në ngarkim të personave që i kanë në administrim.

Për pasaktësitë e konstatuara, sipas rastit për mungesat në aktive, të kërkohet zhdëmtimi i vlerave nga personat përgjegjës.

*Brenda Muajit Qershor 2017*

**6. Gjetje nga auditimi:** Dosjet teknike të investimeve të cilat u audituan, rezultuan me mangësi në dokumentacion, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e KM nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 4, paragrafi 4.

**6.1. Rekomandimi:** Bashkia Tepelenë, nëpërmjet Zyrës së Planifikimit të Territorit, të marrë masa për plotësimin e dokumentacionit të dosjeve teknike të investimeve gjatë procesit të zbatimit të kontratave deri në dorëzimin e objektit

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga Bashkia Tepelenë dhe Njësitë Administrative në vartësi të saj, janë lidhur disa kontrata për dhënie me qira të pronave publike dhe tokave bujqësore të pa ndara. Në këto kontrata, nuk janë përcaktuar qartë detyrimet e ndërsjellta lidhur me afatet e pagesës dhe penaltete për mos pagimin e vlerës së kontratës.

**7.1. Rekomandimi:** Sektori juridik dhe i financës, të bashkërendojnë punën me Njësitë Administrative dhe të marrë masa për rregullimin e kontratave të dhënies me qira të pronave publike, aseteve dhe tokave bujqësore të pa ndara, duke përcaktuar qartë detyrimet kontraktuale.

*Brenda Muajit Maj 2017*

**8. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Tepelenë, është krijuar dhe funksionon struktura e Inspektoratit e Mbrojtjes të Territorit (IMT), sipas miratimit me vendim të Këshillit të Bashkisë, e përbërë nga 1 inspektor. Nga IMT-ja Tepelenë, është marrë vendimi nr. 1, datë 19.12.2016 “Për prishje objekti”, është vendosur masa administrative “gjobë” në shumën 500,000 lekë, është njoftuar Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe datë 19.12.2016, është bërë kallëzim në Prokurorinë e Shkallës së Parë Gjirokastrë.

Për arkëtimin e vlerës së gjobës, nuk është ndjekur rruga ligjore me padi në gjykatë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” nenet 20, 30 dhe ligjit nr. 183/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar.

-IMT-ja e Bashkisë Tepelenë, nuk ka programuar dhe ushtruar kontrolle mbi gjendjen e territorit dhe ndërtimeve pa leje për gjithë hapësirën në juridiksionin e saj, përfshi Njësitë Administrative, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 183/2014, datë 24.12.2014 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 23 dhe VKM nr. 510, datë 10.6.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorial”, Kreu III, pika 1.

**8.1. Rekomandimi:** Nga IMT-ja e Bashkisë Tepelenë, të merren masat e nevojshme dhe të organizohet puna me programe vjetore e mujore të miratuara nga titullari i bashkisë, për Kontrollin e Territorit në gjithë juridiksionin e vet, përfshi Njësitë Administrative, në zbatim të kërkesave ligjore. Të procedohet sipas kërkesave ligjore, me prishjen e ndërtimeve pa leje të konstatuara dhe arkëtimin e vlerës së gjobës.

*Brenda Muajit Qershor 2017*

**9. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Tepelenë, është organizuar dhe funksionon struktura e Policisë Bashkiake, në përbërjen e së cilës janë kryeinspektori dhe 4 punonjës policie.

Tre punonjës të policisë bashkiake, nuk janë me formim policor, nuk janë marrë në punë me komision të ngritur sipas kërkesave ligjore. Me punonjësit e policisë bashkiake, nuk janë lidhur kontrata pune me afat mbi dy vjeçar siç janë kërkesat ligjore.

Në këtë rast, punësimi i punonjësve të policisë, është në shkelje të kërkesave të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë bashkiake" i ndryshuar, neni 4 dhe Rregulloren e Brendshme "TIP" të Policisë Bashkiake dhe Komunës miratuar me Urdhrin e Përbashkët të Ministrisë së Pushtetit Vendorë dhe Ministrisë së Rendit Publik nr. 1, datë 17.04.2003 "Për miratimin e rregullores TIP të policisë bashkiake dhe të komunës", pika 11.

Aktiviteti i policisë bashkiake, nuk është i dokumentuar me programe pune mujore e vjetore si dhe me urdhra të miratuara nga titullari i bashkisë.

Nga policia bashkiake, për periudhën objekt auditimi, janë dhënë gjithsej 44 raste të masës së gjobës për shkeljet e ndryshme të konstatuara në vlerën totale 31,500 lekë, nga të cilat janë pa arkëtuar 43 raste për shumën 51,000 lekë e cila është e ardhur e munguar për buxhetin e bashkisë.

-U konstatua se daljet nga magazina të fletëve të gjobave (bllloqet e gjobave) për punonjësit e policisë bashkiake, nuk janë evidentuar në mënyrë kontabël në debi të personave që i kanë tërhequr ato, pasi nuk janë trajtuar si letra me vlerë, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1497, datë 19.11.2009 "Për shtypjen e letrave me vlerë" i ndryshuar, pika 2.

**9.1. Rekomandimi:** Të merren masa që të riorganizohet struktura e Policisë Bashkiake, me personel të kualifikuar, të disiplinohet aktiviteti i saj me programe dhe detyra të qarta të urdhëruara nga Titullari i Bashkisë e Këshilli Bashkiak, të organizohet evidenca kontabël për bllloqe e gjobave sipas kërkesave ligjore si dhe të procedohet sipas kërkesave ligjore për arkëtimin e vlerës së gjobave për 51,000 lekë.

*Brenda Muajt Korrik 2017*

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të rikërkuara nga KLSH-ja, dërguar me shkresën nr. 437/56, datë 31.07.2013, Kryetari i Bashkisë Tepelenë, i ka kthyer përgjigje KLSH-së me shkresën nr. 706, datë 27.08.2013, u konstatua se :

Nga 2 masa organizative, të rikërkuara, janë zbatuar plotësisht 2 masa organizative.

Nga 4 masa të rikërkuara për shpërblimin e dëmit në shumën 1,462,092 lekë nga 5 persona fizikë, nuk janë zbatuar. Nga 1 person i ankuar, Gjykata e Apelit, ka lënë detyrimin për të paguar shumën 190,545 lekë nga vlera totale e dëmit të rikërkuar në shumën 456,972 lekë.

Nga 2 masa administrative të rikërkuara për vendosjen e masës së gjobës në vlerën 550,000 lekë ndaj mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve të ndërtimit, është vendosur masa e gjobës por nuk është proceduar sipas kërkesave ligjore për arkëtimin e vlerës së gjobës.

**10.1. Rekomandimi:** Bashkia Tepelenë, të marrë masat e nevojshme për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së të rikërkuara me shkresën nr. 437/56, datë 31.07.2013. Të ndiqen të gjitha procedurat ligjore për shpërblimin e dëmit të pa arkëtuar në shumën 1,462,092 lekë dhe vlerës së gjobave për 550,000 lekë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga të dhënat e faqes zyrtare elektronike të Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës, rezulton se në territorin e Bashkisë Tepelenë, nga Ministria e linjës, janë dhënë leje për shfrytëzim të inerteve për dy subjekte: "██████" shpk dhe "██████" shpk të cilat vazhdojnë të kryejnë aktivitetin e tyre.

-Bashkia Tepelenë, nuk ka lidhur kontrata për shfrytëzimin mineral me këto dy subjekte, ku subjekti "██████" shpk, ka ushtruar aktivitetin e vet në ish Komunën Qendër nga viti 2000 dhe subjekti "██████" shpk nga viti 2006.

-Këto subjekte, nuk kanë paguar detyrimet për tatim dhe taksat lokale nga periudha që kanë filluar aktivitetin e tyre në shumën **4,169,590 lekë**, nga të cilat: 3,662,820 lekë për subjektin "██████" shpk dhe 506,770 lekë për subjektin "██████" shpk.

-Përsa kanë shfrytëzuar sipërfaqet pyjore, pa kontrata dhe nuk kanë paguar detyrimet sipas tarifave të llogaritura me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", pika 6, llogaritet 2,728,000 lekë me dëm ekonomik, nga të cilat:

Për subjektin: "██████" shpk; 0,3 ha x 440,000 lekë/ha/në vit x 17 vite= **2,244,000 lekë**.

Për subjektin: "██████" shpk; 0,1 ha x 440,000 x 11 vite = 484,000 lekë.

Mosveprime në shkëlqje të kërkesave të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë" nenet 4, 24, 36, 37, 38, ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimi e qeverisjes vendore" i ndryshuar nenet 8, 10, ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenet 8, 9, 10, ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore".

**11.1 Rekomandimi:** Të merren masat, të procedohet sipas kërkesave ligjore për arkëtimin e shumës **6,897,590 lekë** nga të cilat 2,728,000 lekë, tarifa për shfrytëzim të sipërfaqes pyjore; - 5,906,820 lekë nga subjekti "██████" shpk dhe 990,770 lekë nga subjekti "██████" shpk.

Të merren masa që me këto dy subjekte, të lidhen kontrata për shfrytëzimin e sipërfaqes pyjore sipas lejes së shfrytëzimit mineral të miratuar nga Ministria e Industrisë dhe Energjetikës.

*Brenda Muajt Korrik 2017*

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:**

Mbështetur në nenet 98-102 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", nenet 21-33 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pikën 93 të Udhëzimit të Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", nga ana e titullarit të njësisë publike, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare me qëllim shpërblimin e dëmit **në vlerën 74,908,744 lekë**, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare Sinanaj, Komuna Lopës Tepelenë", viti 2012, me fondin limit 38,608,073 lekë pa tvsh, procedurë "E hapur", marrin pjesë 6 OE. Fitues është shpallur OE "██████" shpk me vlerë të ofertës 38,483,432 lekë pa tvsh.

U konstatua se KVO ka skualifikuar pa të drejtë operatorin ekonomik me ofertë më të ulët. Në këtë rast, diferenca nga vlera fituese, është **14,751,486 lekë** (38,483,432- 23,856,587) **e cila përbën dëm ekonomik** për buxhetin e shtetit.

Është skualifikuar operatori me ofertë më të ulët për 23,856,587 lekë me arsyetimin se nuk është i pajisur me certifikatën ISO 9001 sipas kriterëve të përcaktuara, si dhe nuk ka mjetet dhe asetet e domosdoshme për realizimin e kontratës. Rezulton se skualifikimi është bërë në

mënyrë të padrejtë pasi certifikata ISO 9001 nuk është kërkuar në kriteret e veçanta, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, nenet 1, 2, 20.

**1.1. Rekomandimi:** Bashkia Tepelenë, të marrë masa, të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme ligjore për arkëtimin e vlerës **14,751,486 lekë** nga A.Ç. ish Kryetar i Komunës Lopës.

*Brenda Muajt Qershor 2017*

**2. Gjetje nga auditimi:** Në objektin “Rikonstruksion i Shkollës 9-Vjeçare Sinanaj”, ish-Komuna Lopëz, Tepelenë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren, rezultuan diferenca më tepër në vlerën **13,897,158 lekë pa tvsh duke shkaktuar dëm ekonomik**, nga të cilat vlera 13,518,964 lekë pa tvsh për punime të pakryera në fakt dhe vlera 378,194 lekë si pasojë e përfshirjes në situacionin përfundimtar të tvsh-së për pajisjet, duke mos zbatuar kontratën nr. 37, datë 22.10.2012 dhe preventivin e paraqitur në tender.

**2.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Tepelenë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **13,897,158 lekë** pa tvsh nga OE “██████████” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 37, datë 22.10.2012 me objekt: “Rikonstruksion i Shkollës Vjeçare Sinanaj”, ish-Komuna Lopëz, Tepelenë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si pasojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

*Brenda Muajt Korrik 2017*

**3. Gjetje nga auditimi:** Në objektin: “Rikonstruksioni i Hyrjes “Ali Pasha”, Vazhdimi i Shëtitores Përgjatë Kalasë dhe Rikonceptimi i Rugës Batalioni “Baba Abaz”, Bashkia Tepelenë, nga auditimi i dokumentacionit teknik mbi hartimin e projektit të zbatimit dhe preventivit të punimeve të ndërtimit, të administruara në dosjen teknike, rezulton se janë preventivuar tepër fond limit, si pasojë e rritjes fiktive të çmimeve të krahasuar me manualin teknik të çmimeve, në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë fushën e kontrollit dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, fushën menaxhimit financiar dhe kontrollit, fushën e prokurimit publik, duke i shkaktuar buxhetit të Bashkisë Tepelenë **dëm ekonomik në vlerën 11,817,467 lekë** pa tvsh.

**3.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Tepelenë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **11,817,467 lekë** pa tvsh nga OE “██████████” shpk, në cilësinë e hartuesit të projekt preventivit me objekt: “Rikonstruksioni i Hyrjes “Ali Pasha”, Vazhdimi i Shëtitores Përgjatë Kalasë dhe Rikonceptimi i Rugës Batalioni “Baba Abaz”, Bashkia Tepelenë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të Bashkisë Tepelene si pasojë e rritjes fiktive të fondit limit.

*Brenda Muajt Korrik 2017*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga Zyra e Tatim Taksave, janë evidentuar detyrime të pa arkëtuara për vitet 2012-2016, të pa kontabilizuara, gjithsej **5,917,096 lekë, e cila përbën mungesë e të ardhurave me dëm ekonomik**, nga të cilat:

-3,207,540 lekë detyrime nga biznesi i madh,

-2,475,366 lekë nga biznesi i vogël dhe

-234,190 lekë nga subjektet shtetërore

Në vitin 2016, janë evidentuar debitorë 21 subjekte të mëdha për vlerën 1,407,620 lekë, 128 subjekte të vogla për vlerën 1,999,686 lekë dhe 3 subjekte shtetërore për vlerën 99,710 lekë.

Për vitet 2012-2015, nuk janë programuar të ardhura nga taksat dhe tarifatat për familjare.

Vjelja e tatim taksave familjare, bëhet nga agjenti tatimor “Ujësjellës Kanalizime” sha Tepelenë.

-Nga Zyra e Tatim Taksave të Bashkisë Tepelenë, nuk janë krijuar regjistrat mbi evidentimin e taksës mbi tokën bujqësore, dhe taksën për ndërtesën, nuk janë marrë të dhënat e nevojshme nga Njësitë Administrative (ish komuna) dhe nga ZVRPP mbi pronësinë mbi tokën bujqësore dhe ndërtesat, në kundërshtim me nenet 20 dhe 24 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

-Nga Zyra e Tatim Taksave të Bashkisë Tepelenë, nuk është nxjerrë njoftim vlerësimi për arkëtimin e taksave familjare, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore” i ndryshuar neni 23 dhe Udhëzimit Plotësues të buxhetit të Ministrisë Financave nr. 03, datë 17.01.2014 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2014”, pika 52.

-Për arkëtimin e detyrimeve nga bizneset e vogla debitorë, nuk u janë dërguar bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore” i ndryshuar nenet 90, 93.

-Nuk është llogaritur dhe arkëtuar penalitet ndaj bizneseve debitorë, në masën 0,06% kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore” i ndryshuar, neni 114.

**4.1. Rekomandimi:** Nga Zyra e Tatim Taksave në Bashkinë Tepelenë, të merren masa për arkëtimin e detyrimeve debitorë për **5,917,096 lekë** dhe të bëhen njoftim vlerësimet tatimore për biznese debitorë, bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore” i ndryshuar, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

**Tu dërgohen Bankave urdhrat e bllokimit** të llogarive në banka, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”.

**Ti kërkohet Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit** vendosja e barrës siguroese, (për mjetet) dhe Zyrës Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (për pasuritë) bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat tatimore në R.SH” të ndryshuar me ligjin nr. 164/2014 datë 15.12.2014, ndaj tyre të llogariten kamat vonesa (gjohë në masën 0,06% të detyrimit për çdo ditë vonesë por jo më tepër se 365 ditë).

-Nga ana e Zyrës së Tatim Taksave Bashkia Tepelenë, të listohen në mënyrë elektronike abonentët familjarë dhe të merren masa për arkëtimin e taksës të tokës nga fermerët dhe taksën e popullatës duke krijuar regjistrat përkatës, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile. Në zbatim të pikës 71, të UMF nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”.

*Brenda Muajt Korrik 2017*

**5. Gjetje nga auditimi:** Në objektin: “*Ndërtim i Ujësjellësit me Vetërrjedhje Bençë-Veliqot*”, ish-Komuna Qendër, Tepelenë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan *punime të pakryera në fakt, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 7,299,438 lekë pa tvsh*, në kundërshtim me kontratën nr.- prot., datë 11.12.2014 dhe preventivin e ofertës fituese paraqitur në tender.

**5.1.Rekomandimi:** Nga Bashkia Tepelenë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **7,299,438 lekë pa tvsh** nga OE “XXXXXXXXXX” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr.- prot., datë 11.12.2014 me objekt “*Ndërtim i Ujësjellësit me Vetërrjedhje Bençë-Veliqot*”, ish-Komuna Qendër, Tepelenë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

*Brenda Muajt Korrik 2017*

**6. Gjetje nga auditimi:** Në objektin: “*Rikonstrukcion i Shëtitores Ali Pasha,*



**Restaurim i Fasadave, Ndriçim, Sistemim Trotuaresh”,** Bashkia Tepelenë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren, rezultuan diferenca më tepër në vlerë, **1,050,000 lekë pa tvsh për punime të pakryera në fakt.**, në kundërshtim me kontratën nr. 001, datë 11.08.2015 dhe preventivin e ofertës fituese paraqitur në tender.

**6.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Tepelenë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,050,000 lekë** pa tvsh nga OE “██████████” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 001, datë 11.08.2015 me objekt: “Rikonstruksion i Shëtitores Ali Pasha, Restaurim i Fasadave, Ndriçim, Sistemim Trotuaresh” Bashkia Tepelenë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të Bashkisë Tepelenë si pasojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

*Brenda Muajt Korrik 2017*

**7. Gjetje nga auditimi:** Në objektin: “**Studim Urbanistik dhe Infrastruktura Zona e Spitalit**”, Bashkia Tepelenë, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren, rezultuan **punime të pakryera në fakt, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 1,153,000 lekë pa tvsh**, në kundërshtim me kontratën nr. 4/4 prot., datë 05.09.2014 dhe preventivin e ofertës fituese paraqitur në tender.

**7.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Tepelenë, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,153,000 lekë** pa tvsh nga OE “██████████” Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 4/4 prot., datë 05.09.2014 me objekt: “Studim Urbanistik dhe Infrastruktura Zona e Spitalit”, Bashkia Tepelenë, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë së qeverisjes vendore si rrjedhojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

*Brenda Muajt Korrik 2017*

**8. Gjetje nga auditimi:** Janë paguar 28 këshilltarë dhe 20 kryetarë fshatrash në shumën totale **4,027,053 lekë**, nga të cilët në ish Komunën Qendër; 15 këshilltarë dhe 14 kryetar fshati në shumën 2,285,823 lekë dhe në ish Komunën Kurvelesh; 13 këshilltarë dhe 6 kryetar fshati në shumën 1,741,230 lekë, pa marrë pjesë në mbledhje, në kundërshtim me nenin 29 dhe 31 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar.

**8.1. Rekomandimi:** Të kërkohet në rrugë ligjore (të nxirret urdhri) për shpërblimin e dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe bëhen ndalesat në vlerën **4,027,053 lekë** nga 19 këshilltarët të cilët nuk kanë marrë pjesë në mbledhje, duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit.

*Brenda Muajt Korrik 2017*

**9. Gjetje nga auditimi:** Nuk janë arkëtuar detyrimet lokale tatim mbi pasurinë për pyjet dhe kullotat, për 28 pronarë subjekt të tatuëshëm në vlerën **3,196,407 lekë** nga të cilat në ish Komunën Kurvelesh për 10 subjekte në vlerën 325,195 lekë, në ish Komunën Qendër për 5 subjekte në vlerën 1,883,592 lekë dhe në ish Komunën Lopës për 13 subjekte në vlerën 987,620 lekë, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 9.

**9.1. Rekomandimi:** Bashkia Tepelenë dhe Njësitë Administrative Kurvelesh, Qendër dhe Lopës, të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve të pa vjela tatim mbi pronësinë për pyjet dhe kullotat në vlerën **3,196,407 lekë**.

*Brenda Muajt Korrik 2017*

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i protokolleve të mbledhjeve për vitet 2012-2016, rezultoi se pjesëmarrja e anëtarëve të këshillit në mbledhjet e zhvilluara në Bashkinë Tepelenë ishte jo e plotë. Në protokoll, ishin evidentuar të gjitha mungesat dhe prezencat e pjesëmarrësve. Nga verifikimi i dokumentacionit të bankës për vitet objekt auditimi, rezultoi se ishin paguar të gjithë anëtarët e këshillit bashkiak edhe pse nuk kishin qenë prezent në mbledhjet e muajve përkatës, në kundërshtim me nenin 29 pika 2, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar në të cilin shprehimisht cilësohet se: “Këshilltari shpërblehet për punën që kryen”. Pagesa e 29 këshilltarëve dhe kryetarë fshatrash për 425 ditë në shumën **3,063,490 lekë** të cilët nuk kanë qenë pjesëmarrës në mbledhje, është e pajustificuar.

**10.1. Rekomandimi:** Të kërkohet në rrugë ligjore (të nxirret urdhri) shpërblimi i dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe bëhen ndalesat në vlerën **3,063,490 lekë** nga 29 këshilltarët e Bashkisë Tepelenë të cilët nuk kanë marrë pjesë në mbledhje, duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit.

*Brenda Muajt Korrik 2017*

**11. Gjetje nga auditimi:** Në vitin 2012, nga Bashkia Tepelenë, janë shpenzuar karburante në sasinë 8,314 litra për vlerën 1,507,369 lekë, pa evidentuar atë me dokumentacion justifikues si fleta udhëtimi, normativa të konsumit të karburantit për mjetet në dispozicion etj.

-Në vitin 2013, janë shpenzuar 6,374 litra karburant për vlerën 1,117,321 lekë, nga të cilat për 5955 litra në vlerën 1,042,125 lekë, nuk janë evidentuar me dokumentacionin e nevojshëm ligjor.

-Në vitin 2014, janë shpenzuar 14,620 litra karburant për vlerën 2,631,368 lekë, nga të cilat për automjetin me drejtues mjeti S.K. ka rezultuar 106 litra për vlerën 19,080 lekë, të pa justifikuar me dokumentacion ligjor.

-Në vitin 2015, janë shpenzuar 22310 litra karburant për vlerën 3,634,672 lekë, nga të cilat për mjetin me drejtues M.M. nuk është justifikuar me dokumentacion sasia prej 1620 litra për vlerën 291,600 lekë.

-Në vitin 2016 janë shpenzuar 39,360 litra karburant për vlerën 5,860,404 lekë.

Nuk është evidentuar me fleta udhëtimi konsumi i karburantit si vijon:

-Për automjetin e administratës me drejtues automjeti S.K. në sasinë 5661 litra për vlerën 843,600 lekë.

-Për automjetin e NJ Administrative Kurvelesh me drejtuesi mjeti A.M. në sasinë 2443 litra për vlerën 364,080 lekë.

-Për automjetin e NJ Administrative Lopës me drejtues mjeti A.O. në sasinë 1788 litra për vlerën 266,400 lekë.

-Për automjetin e pastrimit Volvo F-16 me drejtues L.Sh. në sasinë 1639 litra për vlerën 244,200 lekë, mos veprime në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, pikat 35/a,b,c dhe 36.

**11.1. Rekomandim:** Të nxirren debitorë dhe të kërkohet shpërblimi i dëmit në vlerën **2,028,960 lekë** nga ish drejtuesit e automjeteve që kanë tërhequr karburant dhe nuk kanë justifikuar përdorimin e tij me dokumentacionin e nevojshëm ligjor:

-S.K. për 862,680 lekë,

-M.M. për 291,600 lekë,

-A.M. për 364,080 lekë,

-A.O. për 266,400 lekë,

-L.Sh. për 244,200 lekë.

**Brenda Muajit Korrik 2017**

**12. Gjetje nga auditimi:** Në kundërshtim me nenin 29 dhe 31 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, për vitin 2012, 2013, 2014 dhe 2015 janë bërë pagesa për 13 këshilltarë dhe 5 kryetar fshati të Komunës Lopës për muajt në të cilët nuk kanë marrë pjesë në mbledhje të këshillit të komunës, duke përfituar padrejtësisht për punë të pakryer në shumën **1,624,554 lekë**.

**12.1. Rekomandimi:** Të kërkohet në rrugë ligjore (të nxirret urdhri) për shpërblymje të demit, të kryhen kontabilizimet dhe bëhen ndalesat në vlerën **1,624,554 lekë** nga 18 këshilltarët e Komunës Lopës të cilët nuk kanë marrë pjesë në mbledhje, duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit.

**Brenda Muajit Korrik 2017**

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga të dhënat e pasqyrave financiare dhe rezultateve të inventarizimit për vitin 2016, konstatohen **mungesa inventariale për vlerën 1,600,200 lekë**, nga të cilat:

-1,246,000 lekë mungesë mjet transporti në ish Komunën Lopës dhe

-354,200 lekë mungesa të vlerave inventariale në ish Komunën Qendër.

Nga titullari i Bashkisë, nuk janë marrë veprime ligjore në ngarkim të personave përgjegjës, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, Kap I, nenet 10, 12 Kap. IV, pikat 89, 90, 91, 93 dhe neni 7 i ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar.

**13.1. Rekomandimi:** Bashkia Tepelenë, të marrë masat, të identifikojë personat përgjegjës debitorë për mungesën e mjeteve të transportit dhe vlerave inventariale dhe të kërkojë arkëtimin e vlerës **1,600,200 lekë** nga personat përgjegjës.

**Brenda Muajit Korrik 2017**

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të detyrimeve kontraktuale për dhënien me qera të tokës bujqësore të pa ndarë, u konstatua se në 3 raste, nuk janë arkëtuar detyrimet **në shumën 301,200 lekë**, nga të cilat:

-180,000 lekë nga M.Gj. detyrime sipas kontratës të lidhur me ish Komunën Kurvelesh, 90,000 lekë nga M.S. dhe 63,120 lekë nga Gj.E. detyrime sipas kontratave të lidhura me ish Komunën Lopës dhe 53 fermerë sipas kontratave të lidhura me ish Komunën Qendër.

**14.1. Rekomandimi:** Bashkia Tepelenë, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e detyrimeve kontraktuale në shumën **301,200 lekë** nga:

-M.Gj. për shumën 180,000 lekë,

-M.S. për shumën 90,000 lekë,

-Gj.E. për shumën 31,200 lekë,

- 53 fermerë sipas listës emërore trajtuar fq. 213-234 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Brenda Muajit Korrik 2017**

**15. Gjetje nga auditimi:** Në vitin 2015, nga ish Komuna Qendër, është paguar subjekti “A” shpk për shumën **780,000 lekë** për blerje, furnizim e vendosje pompë për fshatin Dukaj pa pasur dokumentacionin e nevojshëm ligjor. Për kryerjen e këtij shërbimi, kontrata është lidhur me subjektin “██████” shpk datë 8.05.2015 kurse pagesa është për subjektin “██████”, shkelje e kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 35-40.

**15.1. Rekomandimi:** Bashkia Tepelenë, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **780,000 lekë** nga përfituesi “██████████” shpk.

*Brenda Muajt Korrik 2017*

**16. Gjetje nga auditimi:** Janë paguar shpenzime për telefonin celular gjithsej **490,968 lekë** nga të cilat;

-Për ish Kryetarin e Komunës Qendër, R.R. në shumën 245,968 lekë, për ish Kryetarin e Komunës Lopës, A.Ç. në shumën 120,000 lekë dhe për ish Kryetarin e Komunës Kurvelesh, P.M. në shumën 25,000 lekë, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 864, datë 23.7.2010 “Për pajisjen me numër celulari të personave juridikë, publikë”, pikat 1, 8, 9.

**16.1. Rekomandimi:** Bashkia Tepelenë, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **490,968 lekë** nga përfituesi;

- R.R. për vlerën 245,968 lekë,
- A.Ç. për vlerën 120,000 lekë,
- P.M. për vlerën 25,000 lekë.

*Brenda Muajt Korrik 2017*

**17. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i listë pagesave të Komunës Lopës, Qendër dhe Kurvelesh, u konstatua se nuk është llogaritur e ndalur tatimi mbi të ardhurat për 41 ish anëtarë të këshillit të komunave dhe 25 ish kryetarë fshati në vlerën **421,619 lekë**, nga të cilët:

-Për për 13 ish këshilltarë dhe 5 ish kryetar fshati në vlerën 264,978 lekë, ish Komuna Lopës, 15 ish këshilltarë dhe 14 ish kryetar fshati në vlerën 98,321 lekë ish Komuna Qendër dhe 13 ish këshilltarë dhe 6 ish kryetar fshati në vlerën 58,320 lekë ish Komuna Kurvelesh, në kundërshtim me kërkesat e kreu II neni 8 “E ardhur e tatueshme” germa “g” të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” neni 33 “Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat” i ndryshuar me ligjin nr. 83/2014 datë 17.07.2014 dhe 156/2014 datë 27.11.2014.

**17.1. Rekomandimi:** Të kërkohej në rrugë ligjore (të nxirret urdhri) shpërblimi i dëmit, të kryhen kontabilizimet dhe bëhen ndalesat në vlerën **421,619 lekë** nga 66 ish këshilltarët e kryetar fshatrash për tatimin mbi të ardhurat, duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore në të gjitha shkallët e gjyqimit.

*Brenda Muajt Korrik 2017*

**18. Gjetje nga auditimi:** Në vitin 2015, janë paguar 4 persona të kontraktuar për mirëmbajtje rrugësh në vlerën **272,000 lekë**, pa procedurën e prokurimit, pa faturë dhe pa akt marrje në dorëzim të punimeve, shkelje e kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar neni 27 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar Kreu II, neni 8, pikat 1, 2 dhe Kreu IV, neni 40 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, pikat 35-40.

**18.1. Rekomandimi:** Bashkia Tepelenë, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **272,000 lekë** nga përfituesit:

- F.C. për vlerën 68,000 lekë,
- D.I. për vlerën 68,000 lekë,
- Sh.B. për vlerën 68,000 lekë,
- S.M. për vlerën 68,000 lekë.

*Brenda Muajt Korrik 2017*

**19. Gjetje nga auditimi:** Në vitin 2012, janë paguar shpërblime nga fondi i veçantë gjithsej **267,000 lekë** për 29 punonjës, nga të cilat:

-Në ish Komunën Qendër, 153,000 lekë për ish 17 punonjës dhe në ish Komunën Lopës, 114,000 lekë për 12 ish punonjës, në kundërshtim me VKM nr. 849, datë 6.12.2012 “Për një ndryshim në VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar pika 9.

**19.1. Rekomandimi:** Bashkia Tepelenë, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **267,000 lekë** nga 29 persona përfitues sipas listës emërore.

*Brenda Muajt Korrik 2017*

**20. Gjetje nga auditimi:** Në vitin 2015, janë paguar 9 të kontraktuar për mirëmbajtje rrugësh në Njësitë Administrative **në shumën 192,950 lekë**. Për këtë shpenzim, nuk ka urdhër prokurimi, nuk ka preventiv të punimeve, nuk ka akt marrje në dorëzim të punës së kryer, nuk ka faturë, veprime në shkelje të kërkesave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar neni 27 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar Kreu II, neni 8, pikat 1, 2 dhe Kreu IV, neni 40 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, pikat 35-40.

**20.1. Rekomandimi:** Bashkia Tepelenë, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **192,500 lekë** nga përfituesit:

- D.I. për vlerën 38,250 lekë,
- I.M. për vlerën 10,200 lekë,
- V.M. për vlerën 17,000 lekë,
- Q.Q. për vlerën 17,000 lekë,
- N.A. për vlerën 17,000 lekë,
- Y.M. për vlerën 25,500 lekë,
- Gj.E. për vlerën 25,500 lekë,
- Th.C. për vlerën 21,250 lekë,
- M.L. për vlerën 21,250 lekë.

*Brenda Muajt Korrik 2017*

**21. Gjetje nga auditimi:** Sipas dokumentacionit mbi çmimin e aplikuar për blerjen e naftës D2 sipas kontratës së furnizimit lidhur datë 6.03.2015 me sipërmarrësin “████████”, rezulton se midis çmimit të kontraktuar në vlerën 129,11 lekë/litër pa TVSH ose 154,932 lekë me TVSH dhe të çmimit të aplikuar në vlerën 138 lekë/litër pa TVSH ose 166,20 lekë/litër me TVSH, operatori ekonomik “████████” nga mos zbatimi i kushteve të kontratës ka rritur çmimin në vlerën 8,89 lekë/litër pa TVSH duke përfituar padrejtësisht më tepër **shumën 143,396 lekë e cila përbën dëm ekonomik** dhe duhet arkëtohet nga operatori ekonomik “████████”.

**21.1. Rekomandimi:** Bashkia Tepelenë, të marrë masa për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit në vlerën **143,396 lekë** nga operatori ekonomik “████████” si diferencë çmimi karburanti, duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore në të gjitha shkallët e gjykimin.

*Brenda Muajt Korrik 2017*

**22. Gjetje nga auditimi:** Në ish Komunën Kurvelesh, në dy raste për vlerën **127,550 lekë**, janë paguar shpenzime për koktej me pije etj., pa pasur dokumentacionin e nevojshëm ligjor si; mungesa e procesverbalit mbi justifikimin e shpenzimeve, nuk ka program të miratuar dhe as listë emërore të personave përfitues, në shkelje të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 35/a, b, c dhe 36 dhe ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar neni 7.

**22.1. Rekomandimi:** Bashkia Tepelenë, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **127,550 lekë** nga personat urdhërues të shpenzimit:

-P.M. me detyrë ish Kryetar i Komunës për vlerën 63,775 lekë,

-J.H. me detyrë ish Përgjegjës i Zyrës së Financës për vlerën 63,775 lekë.

*Brenda Muajt Korrik 2017*

**23. Gjetje nga auditimi:** Në vitin 2015, nga ish Komuna Qendër, është paguar subjekti "██████" në shumën **107,760 lekë** për blerje pjesë ndërrimi të automjeteve në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm justifikues; nuk ka fletë hyrje në magazinë, nuk ka akt marrje në dorëzim të shërbimit dhe fatura tatimore nuk është e firmosur nga ndonjë përfaqësues të ish Komunës Qendër.

**23.1. Rekomandimi:** Bashkia Tepelenë, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **107,760 lekë** nga përfituesi subjekti "██████".

*Brenda Muajt Korrik 2017*

**24. Gjetje nga auditimi:** Në vitin 2013, nga ish Komuna Qendër, janë paguar në dy raste për 2 punonjës në vlerën **54,000 lekë**, shpenzime për udhëtime e dieta pa pasur dokumentacionin e nevojshëm justifikues, mungon kasa elektronike dhe fatura tatimore me tvsh për fjetje në hotel, dhe nga ish Komuna Lopës, janë paguar në dy raste për 3 punonjës në vlerën **40,000 lekë**, shpenzime për udhëtime e dieta pa pasur dokumentacionin e nevojshëm justifikues, shkelje e kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 35, 36.

**24.1. Rekomandimi:** Bashkia Tepelenë, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **94,000 lekë** nga përfituesit:

-R.R. për 36,000 lekë, me detyrë ish Kryetar i Komunës Qendër,

-A.R. për 18,000 lekë, ish punonjës Komuna Qendër,

-H.S. për 5,000 lekë, me detyrë ish P/Financës Komuna Lopës,

-H.Z. për 15,000 lekë, ish punonjës Komunë Lopës,

-A.Ç. për 20,000 lekë, me detyrë ish Kryetar i Komunës Lopës.

*Brenda Muajt Korrik 2017*

**25. Gjetje nga auditimi:** Në vitin 2014, është paguar personi fizik A.Sh. në shumën **88,500 lekë më shumë se sa vlera e ofertës** të paraqitur për prokurimin e shërbimit për punime me duralumin, veprime në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.1.2007 "Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", pikat 35-40.

**25.1. Rekomandimi:** Bashkia Tepelenë, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **88,500 lekë** nga përfituesi: A.Sh.

*Brenda Muajt Korrik 2017*

**26. Gjetje nga auditimi:** Në vitin 2014, nga ish Komuna Qendër, është paguar subjekti A.M. në shumën 199,200 lekë për aktivitetin me rastin e 70-vjetorit të çlirimit të fshatit Dukaj, nga të cilat në shumën **86,400 lekë** për shpenzime drekë për 50 persona. Për këtë vlerë, nuk ka procesverbal të komisionit për shpenzimet e kryera, nuk ka listë emërore të pjesëmarrësve në drekë, nuk ka program të miratuar, shkelje e kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 35-40 dhe ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" i ndryshuar neni 7.

**26.1. Rekomandimi:** Bashkia Tepelenë, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **86,400 lekë** nga urdhëruesit e shpenzimi:

- R.R. me detyrë ish Kryetar i Komunës Qendër për 32,400 lekë,
- R.K. me detyrë ish Përgjegjës i Zyrës së Financës për 32,400 lekë.

*Brenda Muajt Korrik 2017*

**27. Gjetje nga auditimi:** Në vitin 2016, është paguar personi fizik D.G. në shumën **37,000 lekë** për kryerjen e aktivitetit kulturor koktej me pije për 200 persona pjesëmarrës. Nuk ka program pune për këtë aktivitet dhe as listë për pjesëmarrësit në koktej, veprime në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, pikat 35/a,b,c dhe 36.

**27.1. Rekomandimi:** Bashkia Tepelenë, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **37,000 lekë** nga urdhëruesit e shpenzimi, për kryerjen e aktivitetit kulturor pa dokumentacion argumentues dhe justifikues:

- T.P. me detyrë Kryetar i Bashkisë në vlerën 18,500 lekë,
- S.K. me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Financës në vlerën 18,500 lekë.

*Brenda Muajt Korrik 2017*

**28. Gjetje nga auditimi:** Në vitin 2014, nga ish Komuna Qendër, është paguar subjekti B.H. në shumën 167,000 lekë për aktivitetin me rastin e 100-vjetorit të masakrës së Hormovës, nga të cilat **në shumën 26,000 lekë** për shpenzime drekë për 60 persona. Për këtë vlerë, nuk ka procesverbal të komisionit për shpenzimet e kryera, nuk ka listë emërore të pjesëmarrësve në drekë, nuk ka program të miratuar, shkelje e kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 35-40 dhe ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar neni 7.

**28.1. Rekomandimi:** Bashkia Tepelenë, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **26,000 lekë** nga urdhëruesit e shpenzimi:

- R.R. me detyrë ish Kryetar i Komunës Qendër për 13,000 lekë,
- R.K. me detyrë ish Përgjegjës i Zyrës së Financës për 13,000 lekë.

*Brenda Muajt Korrik 2017*

**29. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës për furnizimin me karburant lidhur datë 23.04.2014 nga Bashkia Tepelenë me subjektin “██████████” sha, u konstatua se nuk është zbatuar çmimi për njësi sipas kushteve të kontratës duke përfutur padrejtësisht më tepër shumën **19,080 lekë e cila përbën dëm ekonomik.**

**29.1. Rekomandimi:** Bashkia Tepelenë, të marrë masa për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit në vlerën **19,080 lekë** nga operatori ekonomik “██████████” si diferencë çmimi për blerje karburanti, duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit.

*Brenda Muajt Korrik 2017*

**30. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës për furnizimin me karburant lidhur datë 13.07.2012 nga Bashkia Tepelenë me subjektin “██████████” shpk, u konstatua se nuk është zbatuar çmimi për njësi sipas kushteve të kontratës duke përfutur padrejtësisht më tepër shumën **17,462 lekë e cila përbën dëm ekonomik.**

**30.1. Rekomandimi:** Bashkia Tepelenë, të marrë masa për arkëtimin e detyrimit në vlerën **17,462 lekë** nga operatori ekonomik “██████████” si diferencë çmimi karburanti për blerje, duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit.

*Brenda Muajt Korrik 2017*

**31. Gjetje nga auditimi:** Në vitin 2014, nga ish Komuna Qendër, është paguar personi fizik D.R. në shumën **10,000 lekë** për aktivitet koktej me nxënësit e shkollës Veliqot, në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm justifikues; nuk ka fletë hyrje në magazinë, nuk ka procesverbal për kryerjen e shpenzimit, listë emërore të personave pjesëmarrësve si dhe dokument tjetër që të vërtetojë kryerjen e këtij shpenzimi, nuk ka faturë.

**31.1. Rekomandimi:** Bashkia Tepelenë, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **10,000 lekë** nga përfituesi D.R.

*Brenda Muajt Korrik 2017*

## **B/1. SHPENZIME ME EFEKTIVITET NEGATIV NË BUXHETIN E BASHKISË:**

**1. Gjetje nga auditimi:** Për 7 procedura prokurimi, u konstatua mos përdorimi me efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet, të fondeve të Bashkisë Tepelenë për vlerën totale të kontraktuar 332,621,460 lekë pa tvsh, në objektet si më poshtë:

”Restaurim i Kalasë së Tepelenës” lloji i procedurës ”Tender i hapur”, viti 2012, fondi limit 3,660,809 lekë pa TVSH,

”Rikonstruksion i sheshit të qytetit dhe hyrjes së Kalasë Tepelenë” lloji i procedurës ”Tender i hapur”, viti 2014, fondi limit 54,062,453 lekë pa TVSH,

”Ndërtim i Ujësjiellit me vetërrjedhje Bëncë-Veliqot, Komuna Qendër Tepelenë”, viti 2014, me fondin limit 28,818,352 lekë pa tvsh, procedurë “E hapur”,

”Sistemim i hyrjes së qytetit të qytetit “Ali P.Tepelena, vazhdim i shëtitores përgjatë kalasë dhe rikonceptim i rrugës “Batalioni Baba Abaz”, prokuruar sipas urdhër prokurimit nr. 170, datë 26.07.2016. Fondi limit 124,986,994 lekë pa tvsh. Procedurë “E hapur”.

”Rikonstruksion i Gjimnazit “Abaz SHEHU”, me këto të dhëna: Urdhër prokurimi nr. 126, datë 10.06.2016. Fondi limit 53,523,378 lekë pa tvsh. Procedurë “E hapur”,

”Rikonstruksioni shëtitores “Ali Pasha” Restaurim i fasadave, ndriçim, sistemim trotuaresh”, Urdhër prokurimi nr. 21, datë 18.06.2015. Fondi limit 74,583,333 lekë pa tvsh. Procedurë “E hapur”,

”Studimi urbanistik dhe infrastruktura e zonës së spitalit Bashkia Tepelenë”, Urdhër prokurimi nr. 50, datë 9.06.2014. Fondi limit 20,428,571 lekë pa tvsh. Procedurë ”E hapur”.

**Rekomandimi:** Bashkia Tepelenë të eliminojë praktikatat që çojnë në efektivitet të ulët të prokurimeve për mallra e shërbime. Për të ardhmen Bashkia Tepelenë të mos kualifikojë operatorë ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kërkesat për kualifikim.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

## **C. MASA DISIPLINORE:**

### **C-I. Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.**

Mbështetur në shkronjën (c) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “llojet e masave disiplinore” shkronja “b” të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe nenin 64 shkronjat **g** dhe **k** të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” **i rekomandojmë** Kryetarit të Bashkisë, që ti kërkojë Komisionit disiplinor të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore për 6 punonjës si më poshtë:



a. “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj”, parashikuar në nenin 58, shkronja “b” për punonjësit si më poshtë:

1. z. S.K. me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Financës,
2. zj. J.K. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit Juridik dhe Burimet Njerëzore.

b. “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë për një periudhë deri në dy vjet”, parashikuar në nenin 58, shkronja “c” për punonjësit si më poshtë:

1. z. S.S. me detyrë përgjegjës i Agjencisë të Menaxhimit të Bujqësisë, Bashkia Tepelenë.
2. z. L.A. me detyrë specialist i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave, Bashkia Tepelenë,
3. z. R.K. me detyrë ish Përgjegjës i Zyrës së Financës të Komunës Qendër për periudhën e auditimit datë 1.04.2013 deri datë 30.06.2015, aktualisht specialist në Zyrën e Tatim Taksave të Bashkisë Tepelenë.
4. z. P.H. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Taksave Bashkia Tepelenë për periudhën 05.05.2016-31.12.2016.

## **C-II. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës**

Mbështetur në shkronjën (c) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të kontratës individuale të punës, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave disiplinore si më poshtë:

a. “Vërejtje me paralajmërim për zgjidhjen e kontratës së punës” për 6 punonjësit e mëposhtëm:

- 1-z. Sh.K. me detyrë ish specialist i Menaxhimit të Pronave Pyjeve dhe Kullotave, Komuna Qendër, aktualisht në Njësinë Administrative Qendër dhe
- 2-z. M.M. me detyrë ish specialist i Menaxhimit të Pronave Pyjeve dhe Kullotave, Komuna Qendër, aktualisht në Njësinë Administrative Qendër,
- 3-z. H.X. me detyrë ish specialist i Menaxhimit të Pronave Pyjeve dhe Kullotave, Komuna Lopës, aktualisht në Njësinë Administrative Lopës dhe,
- 4-z. A.O. me detyrë ish specialist i Menaxhimit të Pronave Pyjeve dhe Kullotave, Komuna Lopës, aktualisht në Njësinë Administrative Lopës,
- 5-z. Sh.L. me detyrë ish specialist i Menaxhimit të Pronave Pyjeve dhe Kullotave, Komuna Kurvelesh, aktualisht në Njësinë Administrative Kurvelesh dhe
- 6-z. K.B. me detyrë ish specialist i Menaxhimit të Pronave Pyjeve dhe Kullotave, Komuna Kurvelesh, aktualisht në Njësinë Administrative Kurvelesh.

Personat e mësipërm nga numri rendor 1 deri në 5 me veprimet apo mos veprimet e tyre, kanë shkelur kërkesat e ligjit nr. 8312, datë 26.03.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, VKM nr. 531, datë 21.08.1998 “Për tokat bujqësore të pandara, UKM nr 3 datë 16.05.2007, Udhëzimit të KM nr. 1, datë 18.07.2012 “Për tokat bujqësore të pandara”, VKM nr. 500 datë 14.09.2001 “Për inventarizimin e pasurisë së paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore “; ligjin nr. 10263, datë 08.04.2010 “Për përdorimin e shfrytëzimin e tokave bujqësore të pa kultivuara”

(VO: Në mënyrë të hollësishme personat, shkeljet për të cilën janë rekomanduar masat disiplinore dhe referenca ligjore për secilin punonjës të Bashkisë Tepelene trajtohen në ANEKSIN A - Sqaruese mbi masat disiplinore, bashkëlidhur këtij Projekt/Vendimi).

### **C-III. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL:**

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Tepelenë (Sektor i Administrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve), pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

- a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.
- b. Të njoftojë Komisionarin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

*Menjëherë*

### **D. MASA ADMINISTRATIVE:**

#### **D.1. Për Inspektoratin e Mbrojtjes Territorit Vendor (IMTV)**

1. Nga Bashkia Tepelenë të merren masa që në mbështetje të ligjit nr. 8402 dt. 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16, t'i kërkojë Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, **të vendosë masë administrative me gjobë në masën 500,000 lekë për Ing. R.S.** (nën cilësinë e përfaqësuesit ligjor të firmës "██████████" Shpk (firma hartuese e projekt preventivit), për shkeljet e konstatuara si më poshtë:

- Në procedurat e hartimit të preventivit të fondit limit me objekt: "Rikonstruksioni i Hyrjes "Ali Pasha", Vazhdimi i Shëtitores Përgjatë Kalasë dhe Rikonceptimi i Rrugës Batalioni "Baba Abaz", Bashkia Tepelenë, nga verifikimi i dokumentacionit teknik rezultoi se janë preventivuar më tepër fond limit në vlerën **13,804,500 lekë pa tvsh**, nga të cilat vlera **11,817,467 lekë pa tvsh (13,804,500 -1,987,033)**, përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si pasojë e rritjes fiktive të çmimeve jo në përputhje me manualin teknik të çmimeve gjatë hartimit të projekt-preventivit. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr., 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit", i ndryshuar, Kreu I, neni 3, Vendimin Nr. 514, datë 15.08.2007 "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit, ndryshuar me vendim nr. 664, datë 26.09.2012 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 514, date 15.08.2007 të Këshillit të Ministrave "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit", e konkretisht pika 2, 3 dhe 9.

*Menjëherë*

#### **D2. Masa Administrative për Agjencinë e Prokurimit Publik**

Referuar parregullsisve dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në procedurat e prokurimeve me vlerë të lartë për periudhën 01.01.2013 deri më 31.12.2014, si dhe përgjegjësisë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative" dhe bazuar në nenin 15 shkronja (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014, "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara në**

procedurat e prokurimeve publike, apo rekomandimin e Autoritetit Kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), ndaj **22 punonjësve për 7 procedura prokurimi** si më poshtë:

**1. S.K.** me detyrë Përgjegjës i Financës së Bashkisë Tepelenë, në cilësinë e Kryetarit të KVO, për procedurat e prokurimit me objekt:

”Restaurim i Kalasë së Tepelenës”,

“Rikonstruksion i sheshit të qytetit dhe hyrjes së Kalasë Tepelenë” *dhe në cilësinë e anëtarit të KVO*, për procedurat e prokurimit:

“Sistemim i hyrjes së qytetit të qytetit “Ali P.Tepelena, vazhdim i shëtitores përgjatë kalasë dhe rikonceptim i rrugës “Batalioni Baba Abaz”,

“Rikonstruksion i Gjimnazit “Abaz SHEHU”,

“Rikonstruksioni shëtitores "Ali Pasha” Restaurim i fasadave, ndriçim, sistemim trotuaresh”,

**2. A.A.** me detyrë specialist, në cilësinë e anëtarit të KVO,

**3. A.R. me detyrë specialist**, në cilësinë e anëtarit të KVO,

**4. H.B.** me detyrë specialist, në cilësinë e anëtarit të KVO,

**5. D.C.** me detyrë specialist, në cilësinë e anëtarit të Njësisë Hartimit të Dokumenteve të (NJHD) tenderit,

**6. E.Ç. me detyrë specialist**, në cilësinë e anëtarit të KVO, dhe

**7. A.P.** me detyrë specialist, në cilësinë e anëtarit të NJHD tenderit, për procedurën e prokurimit me objekt:

”Restaurim i Kalasë së Tepelenës”,

**8. J.K.** me detyrë jurist, në cilësinë e anëtarit të NJHD tenderit, për procedurat e prokurimit me objekt:

”Restaurim i Kalasë së Tepelenës”,

“Rikonstruksion i sheshit të qytetit dhe hyrjes së Kalasë Tepelenë”

“Sistemim i hyrjes së qytetit “Ali P.Tepelena, vazhdim i shëtitores përgjatë kalasë dhe rikonceptim i rrugës “Batalioni Baba Abaz”,

“Rikonstruksion i gjimnazit Abaz Shehu”,

“Rikonstruksioni shëtitores "Ali Pasha” Restaurim i fasadave, ndriçim, sistemim trotuaresh”,

**9. V.A.** me detyrë specialist, në cilësinë e anëtarit të KVO, për procedurën e prokurimit më objekt:

“Rikonstruksion i sheshit të qytetit dhe hyrjes së Kalasë Tepelenë”

**10. V.P.** me detyrë specialist, në cilësinë e anëtarit të KVO, për procedurat e prokurimit më objekt:

“Rikonstruksion i sheshit të qytetit dhe hyrjes së Kalasë Tepelenë”

“Sistemim i hyrjes së qytetit “Ali P.Tepelena, vazhdim i shëtitores përgjatë kalasë dhe rikonceptim i rrugës “Batalioni Baba Abaz”,

“Rikonstruksion i Gjimnazit “Abaz SHEHU”,

“Rikonstruksioni shëtitores "Ali Pasha” Restaurim i fasadave, ndriçim, sistemim trotuaresh”,

**11. S.S.** me detyrë specialist, në cilësinë e anëtarit të NJHD të tenderit, për procedurat e prokurimit më objekt:

“Rikonstruksion i sheshit të qytetit dhe hyrjes së Kalasë Tepelenë”

“Rikonstruksioni shëtitores "Ali Pasha” Restaurim i fasadave, ndriçim, sistemim trotuaresh”,

**12. L.D.** me detyrë specialist, në cilësinë e anëtarit të NJHD të tenderit, për procedurat e prokurimit më objekt:

“Rikonstruksion i sheshit të qytetit dhe hyrjes së Kalasë Tepelenë”

“Rikonstruksion i Gjimnazit “Abaz SHEHU”,

“Rikonstruksioni shëtitores "Ali Pasha” Restaurim i fasadave, ndriçim, sistemim trotuaresh”,

**13. G.M.** me detyrë specialist, në cilësinë e anëtarit të KVO, për procedurat e prokurimit më objekt:

“Sistemim i hyrjes së qytetit se qytetit “Ali P.Tepelena, vazhdim i shëtitores përgjatë kalasë dhe rikonceptim i rrugës “Batalioni Baba Abaz”

“Rikonstruksion i Gjimnazit “Abaz SHEHU”,

“Rikonstruksioni shëtitores "Ali Pasha” Restaurim i fasadave, ndriçim, sistemim trotuaresh”

**14. M.K.** me detyrë specialist, në cilësinë e anëtarit të NJHD të tenderit, për procedurën e prokurimit më objekt:

“Sistemim i hyrjes së qytetit se qytetit “Ali P.Tepelena, vazhdim i shëtitores përgjatë kalasë dhe rikonceptim i rrugës “Batalioni Baba Abaz”,

**15. M.S.** me detyrë specialist, në cilësinë e anëtarit të NJHD të tenderit, për procedurën e prokurimit më objekt:

“Sistemim i hyrjes së qytetit se qytetit “Ali P.Tepelena, vazhdim i shëtitores përgjatë kalasë dhe rikonceptim i rrugës “Batalioni Baba Abaz”,

**16. E.S.** me detyrë specialist, në cilësinë e anëtarit të NJHD të tenderit, për procedurën e prokurimit më objekt:

“Rikonstruksion i Gjimnazit “Abaz SHEHU”,

**17. R.K.** me detyrë Përgjegjës i Financës Komuna Qendër Tepelenë, në cilësinë e Kryetarit të KVO,

**18. A.H.** me detyrë specialist ish Komuna Qendër, në cilësinë e anëtarit të KVO,

**19. Z.B.** me detyrë specialist ish Komuna Qendër, në cilësinë e anëtarit të KVO,

**20. G.G.** me detyrë jurist ish Komuna Qendër, në cilësinë e anëtarit të NJHD të tenderit,

**21. A.M.** me detyrë specialist ish Komuna Qendër, në cilësinë e anëtarit të NJHD të tenderit,

**22. L.J.** me detyrë specialist ish Komuna Qendër, në cilësinë e anëtarit të NJHD të tenderit, për procedurat e prokurimit me objekt:

“Ndërtim Ujësjellësi me vetërrjedhje Bëncë-Veliqot, Komuna Qendër Tepelenë”

“Ndërtim ujësjellësi në fshatin Salari”

#### **E. HEQJE LICENCE:**

Mbështetur në nenin 15 shkronjat (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në VKM nr. 759, datë 12.11.2014 “Për Licencimin Profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit” dhe në nenet 13, 25 dhe pika 1/a, 1/e, e nenit 41, Kreu VI-të, “Sanksione dhe Dispozita kalimtare”, të “Rregullore për Kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe subjekte juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit”, për shkelje të ligjshmërisë në zbatimin e punimeve, në fushën e ndërtimit, *i rekomandojmë* Komisionit të Licencave, pranë Ministrisë të Zhvillimit Urban: **Heqjen e së drejtës për ushtrimin e aktivitetit ose pezullimin e përkohshëm në zbatim** (heqjen e Licencës profesionale), për një afat deri nga 2-3 vjet, si më poshtë:

**1- R.S.** (nën cilësinë e përfaqësuesit ligjor të firmës “XXXXXXXXXX” Shpk (firma hartuese e projekt preventivit);

Lidhur me dëmin ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit dhe njësisë së qeverisjes vendore si pasojë e mangësive të theksuara gjatë hartimit të preventivit në objektin:

“Rikonstruksioni i Hyrjes “Ali Pasha”, Vazhdimi i Shëtitores Përgjatë Kalasë dhe Rikonceptimi i Rrugës Batalioni “Baba Abaz”, Bashkia Tepelenë. Nga auditimi i

dokumentacionit teknik mbi hartimin e projektit të zbatimit dhe preventivit të punimeve të ndërtimit, të administruara në dosjen teknike rezulton se janë preventivuar tepër fond limit, si pasojë e rritjes fiktive të çmimeve të krahasuar me manualin teknik të çmimeve, në kundërshtim me, aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë fushën e kontrollit dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, fushën menaxhimit financiar dhe kontrollit, dhe fushën e prokurimit publik, duke i shkaktuar buxhetit të Bashkisë Tepelenë **dëm ekonomik në vlerën në 11,817,467 lekë pa tvsh.**

Më konkretisht si më poshtë:

1. **“Rikonstruksioni i Hyrjes “Ali Pasha”, Vazhdimi i Shëtitores Përgjatë Kalasë dhe Rikonceptimi i Rrugës Batalioni “Baba Abaz”,** Bashkia Tepelenë.

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike nr. - prot., datë - të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Tepelenë përfaqësuar nga kryetari z. T P dhe operatorit ekonomik “██████████” Shpk, me përfaqësues ligjor P.B. Vlera e kontratës bazë është 122,999,961 lekë pa tvsh ose 147,599,953 lekë me tvsh.

**Mbi hartimin e fondit limit:**

**Diferenca midis fondit limit dhe vlerës së kontratës të lidhur midis palëve, për këtë objekt është 1,987,033 lekë pa tvsh ose 1.59 % më pak se fondi limit.**

Nga auditimi i dokumentacionit teknik mbi hartimin e projekt - preventivit të punimeve të ndërtimit, të administruara në dosjen teknike rezulton se:

- Janë preventivuar më tepër fond limit në vlerën 13,804,500 lekë pa tvsh, nga të cilat 11,817,467 lekë pa tvsh (13,804,500 -1,987,033), përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si pasojë e rritjes fiktive të çmimeve jo në përputhje me manualin teknik të çmimeve gjatë hartimit të projekt-preventivit të objektit: “Rikonstruksioni i Hyrjes “Ali Pasha”, Vazhdimi i Shëtitores Përgjatë Kalasë dhe Rikonceptimi i Rrugës Batalioni “Baba Abaz”, Bashkia Tepelenë.

Diferenca e mësipërme ka ardhur si pasojë vendosjes së çmimeve mbi ato të manualit teknik të çmimeve në fuqi si dhe vendosja në analizë e çmimeve mbi ato të çmimeve të marra nga ofertuesit pas sondazheve të kryera në treg. Si rrjedhojë e veprimeve të mësipërme fondi limit është rritur për vlerën **13,804,500 lekë pa tvsh.**

**Nga hartuesi i projekt preventivit ing. R.S.** është vepruar në kundërshtim me:

- Ligjin nr., 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të dërtimit”, i ndryshuar, Kreu I, neni 3.

- Vendimin Nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit, ndryshuar me vendim nr. 664, datë 26.09.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 514, datë 15.08.2007 të Këshillit të Ministrave “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, e konkretisht pika 2, 3 dhe 9.

**2- Ing. Gj.M. (nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve);**

Lidhur me dëmin ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit dhe njësisë së qeverisjes vendore si pasojë e mangësive të theksuara gjatë zbatimit të kontratës për investime në objektin:

**“Ndërtim i Ujësjellësit me Vetërrjedhje Bençë-Veliqot”,** ish-Komuna Qendër, Tepelenë. Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit rezultojnë diferenca **në volume pune të pakryera dhe përfutim më tepër në vlerën 7,299,438 lekë pa tvsh.**

Më konkretisht si më poshtë:

1. **“Ndërtim i Ujësjellësit me Vetërrjedhje Bençë-Veliqot”,** ish-Komuna Qendër, Tepelenë.

Kontrata me mbikëqyrësin e punimeve mungon në dosjen teknike të objektit.

Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit rezultojnë diferenca ***në volume pune të pakryera dhe përfundim më tepër në vlerën 7,299,438 lekë pa tvsh.***

Është vërejtur cilësi e dobët e punimeve të zbatuara në kundërshtim me kushtet teknike të zbatimit. Nuk është zbatuar projekti i zbatimit i parashikuar për ndërtimin e veprës. Depoja e furnizimit me ujë për fshatin ndodhet në një kuotë më të ulët se ajo e vetë fshatit, duke e bërë atë totalisht jo funksionale. Gjithashtu sipërmarrësi i punimeve nuk ka respektuar dimensionet e projektit, duke e kthyer atë nga konfiguracion me bazë rrethore, në konfiguracion me bazë drejtkëndore. Gjithashtu janë konstatuar **mangësi në dokumentacion si dhe problematikat si më poshtë:**

#### **I. Mangësi në dokumentacion:**

Konstatohet se në dokumentacionin teknik mungojnë:

1. Certifikatat e cilësisë për materialet e përdorura në objekt;
2. Mungojnë provat me ngarkesë në lidhje me ujësjellësin;
3. Mungon pasqyra e realizimit të punimeve sipas formatit tip;
4. Mungon dokumentacioni për masat e sigurimit teknik dhe pajisjen me mjetet mbrojtëse përkatëse;
5. Kontrata me mbikëqyrësin e punimeve;
6. Kontrata me kolaudatorin e punimeve.

#### **II. Mangësitë në zbatimin e punimeve:**

Konkretisht janë përfituar nga sipërmarrësi “**██████**” Shpk më tepër në vlerë, duke i shkaktuar **dëm ekonomik buxhetit të shtetit 7,299,438 lekë pa tvsh** për punime të pakryera.

- Vlera **7,299,438 lekë pa tvsh** si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore. Kjo vlerë ka ardhur si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera por të situacionuara e të pasqyruara në librezën e masave, mosrespektimit të projektit të miratuar si dhe ndryshimin e zërave të punës pa marrë miratimin e projektuesit. Këto veprime janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve, neni 23, pika 23.2 në kontratën me për punë publike nr. - prot., datë 11.12.2014 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor ish-Komuna Qendër, Tepelenë përfaqësuar nga ish-kryetari z. R.R. dhe operatorit ekonomik “**██████**” Shpk, me përfaqësues ligjor z. Nj.P.

**Nga mbikëqyrësi i punimeve, Ing. Gj.M.** është vepruar në kundërshtim me:

-ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7,

- udhëzimin e KM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të KM “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 3.2 dhe 3.3

- me kontratën për mbikëqyrjen e punimeve lidhur me Autoritetin Kontraktor ish-Komuna Qendër, Tepelenë ku përcaktohen Detyrimet e mbikëqyrësit.

#### **E. KALLËZIM PENAL:**

**I. Bazuar në kualifikimin e nenit 248 “Shpërdorimi i detyrës” dhe 258 “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike” të Kodit Penal, bëjmë kallëzim penal për veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për prokurimin publik”, Kreu I, neni 1, pika 2, germa b, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, për:**

1. **Z. A.C.** me detyrë ish-Kryetar i Komunës Lopës, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor,

për procedurën e prokurimit me objekt “*Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare Sinanaj, Komuna Lopës Tepelenë*”, ku ka rezultuar se është skualifikuar operatorin ekonomik me ofertë me vlerë më të ulët me arsyetimin se nuk është i pajisur me certifikatën ISO 9001 sipas kriterëve të përcaktuara, si dhe nuk ka mjetet dhe asetet e domosdoshme për realizimin e kontratës, kur ka rezultuar se OE ka plotësuar kërkesat e DST, si dhe është kualifikuar dhe shpallur fitues OE me ofertë më të lartë, kur nuk ka plotësuar kriteret për kualifikim sipas DST, me pasojë dëm ekonomik në vlerën prej **14,751,486 lekë**.

anëtarët e KVO kanë deklaruar se ***nuk kanë dijeni të kësaj procedure prokurimi*** të realizuar nga ish-Komuna Lopës, dhe se nuk kanë nënshkruar apo realizuar asnjë procedurë prokurimi duke kërkuar ***verifikimin e falsifikimit të dokumentacionit të tenderit*** si dhe arkëtimin e kësaj vlere në arkën e buxhetit të shtetit nga përfituesit fiktiv, si dhe duke u shprehur të gatshëm që si KVO të vihen në dispozicion të gjithë organeve ligj zbatuese.

**II.** Bazuar në kualifikimet e neneve 248 “Shpërdorimi i detyrës” të Kodit Penal, bëjmë kallëzim penal për veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” dhe VKM nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit, ndryshuar me vendim nr. 664, datë 26.09.2012 për:

**2. R.S.** (nën cilësinë e përfaqësuesit ligjor të firmës “**██████████**” shpk (firma hartuese e projekt preventivit) “*Rikonstruksioni i Hyrjes “Ali Pasha”, Vazhdimi i Shëtitores Përgjatë Kalasë dhe Rikonceptimi i Rrugës Batalioni “Baba Abaz”,* Bashkia Tepelenë pasi ka preventivuar më tepër fond limit në vlerën 13,804,500 lekë pa tvsh, nga të cilat 11,817,467 lekë pa tvsh përbëjnë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si pasojë e rritjes fiktive të çmimeve jo në përputhje me manualin teknik të çmimeve gjatë hartimit të projekt-preventivit të objektit.

## **F. INDICIE PËR NDJEKJE PENAL:**

I. Në zbatim të nenit 15 germa “gj.; të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe nenit 248 të Kodit Penal dërgojmë Indicie për Ndjekje Penale, për veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Udhëzimin e Këshillit Ministrave nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar; UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar për:

Mbikëqyrësin e punimeve dhe shoqërinë zbatuese të objektit, “*Ndërtim i Ujësjetës me Vetërrjedhje Bençë-Veliqot*”, për diferenca ***në volume pune të pakryera dhe përfitim më tepër, duke i shkaktuar buxhetit të shtetit një dëm ekonomik në vlerën 7,299,438 lekë pa tvsh***, si dhe cilësi të dobët të punimeve të zbatuara në kundërshtim me kushtet teknike të zbatimit, realizim të investimit pa zbatuar projektin e parashikuar për ndërtimin e veprës si dhe mangësi të theksuara në dokumentacionin tekniko-ligjor.

Bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar”, i ndryshuar, Kallëzimi Penal nuk publikohet.

## **G. TË TJERA**

**G.1.** Mbi ankesën e shoqërisë “**██████████**” sh.p.k, protokolluar në KLSH me nr.1231/14 datë 19.04.2017, në lidhje me pretendimin për pasaktësinë e volumeve të punës dhe dëmin ekonomik të konstatuar nga KLSH, për punime të pakryera në vlerën 8,185,137 lekë, në objektin “*Ndërtim i ujësjellësit me vetërrjedhje Bënçë-Veliqot, Komuna Qendër Tepelenë*”.

Për verifikimin e pretendimeve të shoqërisë “**██████████**” sh.p.k, Kryetari i KLSH-së me autorizimin nr. 1231/15 datë 25.04.2017, ka ngarkuar për verifikim në terren grupin e punës të përbërë nga audituesit shtetërorë të KLSH: Ing. A.Z. Ing. z.I.D.

Më datë 27.04.2017 nga grupi i punës i mësipërm në prezencë edhe të mbikëqyrësit të punimeve të objektit z. Gj.M. u krye verifikimi i punimeve në teren dhe rezultoi se qëndron dëmi ekonomik i konstatuar nga grupi i mëparshëm i auditimit të KLSH në **vlerën 7,299,438 lekë**.

### **G.2. Për Njësinë e Auditit të Brendshëm të Bashkisë Tepelenë.**

Në zbatim të nenit 15, shkronja (i) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, dhe nenit 25 të ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, **Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Tepelenë** së bashku me specialistë të fushës, në bazë të një programi auditimi të miratuar nga Titullari i Bashkisë, **të auditojë më tej**, të gjitha gjetjet e konstatuara të evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH, përfshi dhe ato zëra punimesh të cilat nuk janë evidentuar për shkak të terrenit të vështirë, për zbatimin e punimeve sipas kontratës nr. ska, datë 11.12.2014 me vlerë 28,792,967 lekë pa tvsh, lidhur ndërmjet ish-kryetarit të komunës Qendër dhe operatorit ekonomik “**██████████**” shpk, për objektin: “*Ndërtim i Ujësllësit me vetërrjedhje Bënçë-Veliqot*”, kolauduar më datën 20.04.2015 dhe marrë në dorëzim më datën 12.05.2015.

Për përfundimin e rezultateve të auditimit brenda datës **20.05.2017** të njoftohet edhe Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësive të Qeverisjes Vendore dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**